REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Procesverbal

Konsultim publik : Takim me banorët e Njësisë Administrative Rrajcë

Data : 16.10.2025 **Ora** :15.00 **Vendi**: Pranë shkollës "9-vjeçare Rrajcë Fushë"

Numri i pjesëmarrësve : totali 47; nga të cilët 8 gra dhe vajza, 39 burra (sipas listës bashkëlidhur).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: Buxhetit Afatmesëm 2026-2028, projekt buxheti 2026 si edhe Paketa Fiskale e Bashkisë Prrenjas.

Pjesëmarrës: Janë prezent; Kryetari i Bashkisë Z. Nuri Belba; Nënkryetari i bashkisë Prrenjas Aurel Karriqi; Administratori i Njësisë Rrajcë Islam Golemi; Drejtori i financës Suzana Kapxhiu; Drejtori i Urbanistikës Gordana Karaj; Sekretari i Këshillit Klajdi Lufo, Koordinatori për njoftim dhe konsultimin publik Rudina Kukli; banorë të Nj.A; dhe grupe të interesit.

Gjatë këtij takimi kryetari i Bashkisë Z. Nuri Belba, përshëndeti të ftuarit gjatë fjalës së tij diskutoi për projektbuxhetin 2026 si edhe prioritete në këtë zonë.

Gjatë vitit 2025 u përfundua një ndër investimet më të mëdha dhe me priotare të zonës rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sali Halili".

Për vitin 2026 do të kemi në investime në rrugët e brendshme të fshatrave si edhe do të ndërhyjmë për të përmirësuar qendrën e fshatit Bardhaj.

Në pjesën e Hekurudhës do të kemi një investim e cila do të kalojë në linjën Elbasan-Pogradec, që do të thotë se do të prekë edhe zonën tonë duke sjellë zhvillimin zonës.

Kanalet vaditëse janë problem i vazhdueshëm sidoms gjatë stinës së verës por ne do të ndërhyjmë duke i pastruar dhe mirëmbajtur me mjetet tona.

Mbrojtjen sociale e kemi pasur në fokus dhe do ta kemi duke iu ardhur në ndihmë shtresave më në nevojë. Zona e Rrajcës ka një problem të vazhdueshëm sa i përket energjisë elektrike sidomos gjatë stinës së dimrit jemi munduar që të edhe me OSHE të lidhim një marrëveshje që të bëhet vendosja e kabullit ABC.

Tjetër problem i Njësisë Rrajcë mbetet edhe problemi me vendin kufitar Maqedoninë ku shumë banorë të kësaj zone shkojnë edhe vijnë brenda ditës, do të negociojmë që të lidhim një marrëveshje dy palëshe me shtetin fqinj në mënyrë që të krijojnë lehtësira për ata që punojnë jashtë territorit.

Mbetjet janë problem shqetësues edhe për këtë duhet një ndërgjegjësim dhe punë nga gjithë komuniteti në mënyrë që edhe mbetjet mos hidhen në çdo vend.

Shyqyri Vasku dhe **Nazmi Alla** ngritën shqetësimin për vendvarrezat të cilat janë problem shqetësues për gjithë komunitetin dhe duhet dhënë një zgjidhje.

Bashkim Çuku rekomandon për rrugët e brendshme të fshatit të sistemohen dhe rregullohen duke mos krijuar problem kryesisht në dimër.

Tina Bogdani shpreh shqetësimin për kanalet vaditëse duhet të kenë ujë kryesisht në verë .

Qyzel Halili shtron problem për shtim të kazanave të plerave dhe sidomos kjo në afërsi të shkollave hidhen mbetje mbeturinash gjithandej duhet filluar ndërgjegjësimi në çdo nivel.

Belul Bogdani shpreh interesin për “Paketën e Maleve” si edhe kush do të jenë përfituesit e këtij projekti.

Mbajtësi i procesverbalit

Koordinatori për Njoftimet dhe konsultimet publike

Rudina Kukli









REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Procesverbal

Konsultim publik : Takim me banorët e Nj.A Qukës, fshati Karkavec

Data : 14.10.2025 **Ora** :16.00 **Vendi**: Pranë shkollës "Arif Kuka"

Numri i pjesëmarrësve : totali 38; nga të cilët 8 gra dhe vajza, 30 burra (sipas listës bashkëlidhur)

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: Buxhetit Afatmesëm 2026-2028, projekt buxheti 2026 si edhe Paketa Fiskale e Bashkisë Prrenjas.

Pjesëmarrës: Janë prezent nga ana e bashkisë, Kryetari i Bashkisë Z. Nuri Belba; Administratori i Njësisë Qukës Oltion Bajrami; Drejtori i financës Suzana Kapxhiu; Anëtarë të këshillit bashkiak Prrenjas, Fatmir Kryeziu dhe Xhek Nezha; Përgjegjësi i Taksave Ahmet Goci, sekretariati kryetarit Esmeralda Kanani; Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Rudina Kukli; sekretari i Këshillit Bashkiak Klajdi Lufo, banorë të Nj.A; dhe grupe të interesit.

Takimi drejtohet nga Kryetari i Bashkisë Z. Nuri Belba, gjatë fjalës së tij përshëndeti të pranishmit duke përmendur investime të rëndësishme që janë bërë për Njësinë Administrative Qukës si edhe me buxhetin e bashkisë këtë vit është bërë dhe asfaltimi i fshatit Gurrë një investim i shumë pritur për banorët siç u bë për fshatin Qukës-Skënderbe dhe të tjera. Do ndërhyjmë në lagjet e brendshme të fshatrave si "lagja e Benos", "Lagja e Kalës". Prioritet për vitin 2026 do të kemi asfaltimin e rrugës të Fshatit Fanjë një kërkesë e hershme e banorëve të zonës. Gjithashtu do të vijojmë punën

për mirëmbajtjen e kanaleve vaditëse duke filluar nga kanalet Stranik-Dritaj, kanalet vaditëse në Qukës dhe në fshatrat e tjera ku kërkohet ndërhyrje.

Shërbimi social do të vijojmë mbështetjen ndaj grupeve vulnerabël dhe shtresave më në nevojë duke ju ardhur në ndihmë. Kemi përfituar disa projekte për bashkinë Prrenjas për punësimin e të rinjve si edhe për disa zonja me një orar të reduktuar por që i vjen në ndihmë zonës.

Problem shqetësues tjetër për zonën është restaurimi i qendrave shëndetësore , ne do të vijojmë ti kemi në duke ndërhyrë dhe i rregulluar kushtet e nevojshme.

Istref Vlashi sygjeron se duhet ndërhyrë në rrugët e brendshme të fshatrave në mënyrë që të jenë sa më të aksesueshme si edhe problem tjetër për të janë vendvarrezat.

Zylfije Gega – Kryetare fshati shtron problemin për zgjidhjen e problemeve siç janë Qendrat Shëndetësore, kanalet vaditëse si edhe linja energjitike e OSHE.

Mevlut Belba kryeplak i fshatit Skroskë ngre shqetësimet për shtim të kazaneve të plerave, kanalet vaditëse sepse mungon uji gjatë stinës së verës si edhe uji i Varovës mbetet problem.

Filo Alliu- kryeplak i fshatit Qukës – Shkumbin shtron problemet si kanalet vaditëse mbeten shqetësim, ujërat e zeza sidomos te “lagja e Kryeziut” ku shtëpitë janë shumë pranë.

Petrit Zogolli shpreh falenderime për punët e bëra kryesisht në fshatin Karkavec, rekomandon gjatë në afësi të shkollës të sinjalistika e nevoshme në mënyrë që të ulet shpejtësia e automjeteve.

Mbajtësi i procesverbalit

Koordinatori për Njoftimet dhe konsultimet publike

Rudina Kukli




BASHKIA PRRENJAS




BUXHETIM ME

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

BASHKIA PRRENJAS

Procesverbal

Konsultim publik : Takim me Këshillin Rinor Vendor Prrenjas, qyteti Prrenjas

Data : 25.10.2025 **Ora** :10.00 **Vendi**: "Salla e Këshillit bashkiak"

Numri i pjesëmarrësve : totali 16; nga të cilët 13 vajza, 3 burra (sipas listës bashkëlidhur).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: Buxhetit Afatmesëm 2026-2028, projekt buxheti 2026 si edhe Paketa Fiskale 2026 e Bashkisë Prrenjas.

Pjesëmarrës: Nga bashkia Prrenjas janë prezent: Nënkryetari i bashkisë Prrenjas Aurel Karriqi; Përgjegjësi i financës Bukuroshe Kanani; koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Rudina Kukli, të rinj dhe të reja të Këshillit Rinor Prrenjas.

Gjatë këtij takimi me të rinjtë e Këshilllir Rinor Prrenjas u diskutua në lidhje me hartimin e buxhetit 2026 duke dhënë rekoandime dhe sygjerime në kuadër të buxhetit.

Në takim ishte i pranishëm Nënkryetari i Bashkisë i cili i kushtoi një vëmendje të veçantë sektorit rinor në këtë bashki duke u thënë se nga ana e bashkisë nuk do të mungojë vëmendja për ta.

Të rinjtë e këshillit rinor theksuan rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe buxhetore të bashkisë dhe ngritën një sërë problematikash më kryesoret:

- Infrastruktura në shkolla, krijimi i laboratoreve përkatëse
- Vendosja e kamerave të sigurisë në shkolla për të survejuar ambjentin
- Hapja e qendre rinore për të rinjtë e Prrenjasit
- Mbështetje për aktivitete kulturore dhe sportive për të rinjtë
- Projekte për edukim mjedisor dhe pastrime vullnetare në Parkun Kombëtar Shebenik.

Nga ana e drejtorisë së financës u konsiderua e rëndësishme dhe do të reflektohet në buxhetin e bashkisë rekomandimet e të rinjve.

Mbajtësi i procesverbalit

Koordinatori për Njoftimet dhe konsultimet publike

Rudina Kukli


BASHKIA PRRENJAS


BASHKIA
PRRENJAS


BASHKIA
PRRENJAS
BASHKIA PRRENJAS



Procesverbal

Konsultim publik : Takim me banorët e bashkisë Prrenjas, qyteti Prrenjas

Data : 24.10.2025 **Ora** :16.00 **Vendi**: "Qendra Kulturore Prrenjas"

Numri i pjesëmarrësve : totali 135; nga të cilët 81 gra dhe vajza, 54 burra (sipas listës bashkëlidhur).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: Buxhetit Afatmesëm 2026-2028, projekt buxheti 2026 si edhe Paketa Fiskale 2026 e Bashkisë Prrenjas.

- **Pjesëmarrës**: Janë prezent: Kryetari i Bashkisë Z. Nuri Belba ; Nënkryetari i bashkisë Prrenjas Aurel Karriqi; Drejtori i financës Suzana Kapxhiu; Drejtori i Urbanistikës Gordana Karaj; Anëtarë të këshillit bashkiak Klodjan Karriqi, koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Rudina Kukli; sekretari i Këshillit Bashkiak Klajdi Lufo; banorë të bashkisë Prrenjas si mësues, mjekë, edukatorë, punonjës, fermerë, të rinj, biznese, infermierë; dhe grupe të interesit.

- Takimi u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Z. Nuri Belba, gjatë fjalës së tij diskutoi për projektbuxhetin 2026 si edhe prioritete që do të ketë qyteti i Prrenjasit.

- Një ndër shqetësimet kryesore të qytetit Prrenjas është problemi i rrugëve në qytet kjo edhe për shkak të punimeve që po kryhen ne qytet duhet kerkuar mirëkuptimi juaj për situatën do përpiqemi ta normalizojmë sa më shpejt.
- Nga buxheti i vitit 2026 do të shikojmë me prioritet ndërtimin e unazës që përfshin nga lokali Bitrit-Shkolla e mesme- lagja e karriqit-lagja e kromit si edhe rrugët në lagjet e brendshme.

  Arsimi do të jetë në vëmendjen tonë po punojmë te gjimnazi "Halit Bërzeshta" për fushat me parametrat e duhura si edhe do ndërtojmë Qendrën Rinore për të rinjtë. Do të kemi në fokus rikonstruksionin e gjimnazit të qytetit ta kthejmë në model si është bërë Rrajca, do të përmirësojmë kushtet edhe për shkollën 9 vjeçare "Qybra Sokoli" duke i kushtuar vëmendje të veçantë arsimit. Arsimi do të vijojë të mbetet një prioritet i bashkisë duke ndërhyrë në infrastrukturën për një proces sa më cilësor dhe me kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor.

- Përmirësimi i kushteve të banesave për shtresat në nevojë mbetet një projekt i rëndësishëm që do të vijojë duke ndihmuar kategori të caktuara, do përmirësojmë jetesën e qytetarëve siç ndërhymë me fasadat e pallateve të qytetit Prrenjas si edhe shtrimin me pllaka të shesheve dhe hapsirave përreth.
- Shërbimi Social mbetet fokus i veçantë i bashkisë Prrenjas me anë të projekteve sociale do përfitojnë kategori të caktuara grupesh siç është projekti social që janë disa zonja përfituese të projektit apo edhe projekti për të rinjtë e papunë do të punësohen për një vit me një orar të reduktuar rreth 4 orë përfitojnë punësim. Qendra për personat me PAK do të vijojë të qëndrojë e hapur dhe të ofrojë shërbime për kategoritë e caktuara që kanë nevojë.
- Një tjetër prioritet i rëndësishëm për bashkinë Prrenjas do të jetë fokusi i Artit dhe kulturës, trashëgimisë kulturore do të japim mbështetje maksimale nga ana jonë si institucion për të

ruajtur gjallë traditat. Mendojmë që një festival Folklorik ta bëjmë lart në fshatin Sutaj si pjesë e kulturës sonë.

Axhem Karriqi shtron problemin e ujërave të zeza kryesisht në lagjen e Karriqit mbeten një problem i hershëm dhe i duhet dhënë një zgjidhje.

Flori Kokonozi pyet për një investim të përpunimit të nikelit dhe fabrikë tullash që do të hapet në Prrenjas dhe cilat do të jenë përftimet e komunitetit nga kjo gjë.

Kryetari sqaron se po diskutohet që ky projekt të vijë në Prrenjas dhe do të jetë në dobi të komunitetit sepse do të punësohen njerëz të zonës, por ky projekt mbetet në fazën e projektidesë dhe nuk kemi në fazën finale për ta zbatuar.

Shaban Karriqi kryeplak i Prrenjasit-Fshat shtron problemin për pjesën e ndriçimit në këtë lagje e cila nuk duhet të mungojë por të ketë ndriçim unaza gjatë gjithë kohës.

Kryetari sqaron se do të bëhet unaza e madhe e cila patjetër do jetë edhe me ndriçimin përkatës duke iu ardhur në ndihmë banorëve.

Nesti Qorri kryeplak i fshatit Rashtan është falenderues për asfaltimin e rrugës së Rashtanit por shton problemin se duhen shtuar edhe kazanët e plerave, gjithashtu kjo rrugë duhet të lidhet me rrugën Qafë-Plloçë.

Mbajtësi i procesverbalit

Koordinatori për Njoftimet dhe konsultimet publike

Rudina Kukli


BASHKIA PRRENJAS
BUXHETIM ME
PJESËMARRJE







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Procesverbal

Konsultim publik : Takim me banorët e Nj.A Stravaj

Data : 21.10.2025 **Ora** :13.00 **Vendi**: Pranë shkollës "Ahmet Elezi"

Numri i pjesëmarrësve : totali 36; nga të cilët 11 gra dhe vajza, 25 burra (sipas listës bashkëlidhur)

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: Buxhetit Afatmesëm 2026-2028, projekt buxheti dhe Paketa Fiskale e Bashkisë Prrenjas 2026.

Pjesëmarrës: Janë prezent: Nënkryetari i bashkisë Prrenjas Aurel Karriqi ; Administratori i Njësisë Stravaj Nelsi Çekrezi ; Drejtori i financës .Suzana Kapxhiu; Anëtarë të këshillit bashkiak Flutura Haka; Drejtori i Agjencisë së Funksioneve dhe Shërbimeve Edionald Durbaku; Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Rudina Kukli; banorë të Nj.A; dhe grupe të interesit.

- Takimi u drejtua nga Nënkryetari i Bashkisë Z.Aurel Karriqi dhe anëtarja e Këshillit Bashkiak Flutura Haka.
- Gjatë këtij takimi u diskutua hartimi i projekt buxhetit 2026 si edhe prioretet për këtë vit në Njësinë Stravaj.
- Problemi kryesor në këtë Njësi Administrative vazhdon të mbetet rruga. Janë bërë gjitha përpjekjet nga ana e pushtetit lokal që kjo rrugë të marrë investimin e duhur dhe banorët të kenë mundësi të lëvizin pa problem.

- Problem tjetër për Njësinë Administrative mbetet problemi me energjinë elektrike jemi në dijeni të problemit se çfarë ndodh me energjinë elektrike dhe për këtë problem kemi folur edhe përfaqësues të OSHE dhe na kanë premtuar se do ta zgjidhin këtë situatë.

- Ujësjellësi ka disa probleme në disa fshatra kjo edhe pasi uji i pijshëm shpërdorohet për vaditje gjatë stinës së verës dhe kjo gjë çon në mungesë dhe kufizim të ujit të pijshëm. Duhet të vendosen sahat dhe matës të paguhet për sa harxhohet dhe nuk duhet të shpërdorohet. Bashkia do t'ju vijë në ndihmë për pastrimin e kanaleve vaditëse që mos mungojë uji i për vaditje gjatë stinës së verës.
- Tjetër prioritet që duhet të marrë zhvillim për zonën e Stravaj mbetet promovimi dhe zhvillimi i turizmit. Njësia Stravaj ka atraksione dhe pasuri që duhet të promovohen duke nxitur turizmin. Bimët medicinale janë pasuri e madhe e kësaj zone duhet krijohet një pikë grumbullimi e cila të mbledhë bimët medicinale duke u krijuar dhe kushte për tu shitur.
- Njësia Stravaj ka potenciale që duhen shfrytëzuar duke i dhënë përparësi hapjes së bujtinave, tregtimit agro ushqimor, produkte të bulmetit etj.
- Në këtë takim u diskutua edhe për **Paketën e Maleve** të cilët banorët ishin mjaft të interesuar për të përfituar nga ky program.

  Shkëlqim Jelina ngre shqetësimin për problemin e energjisë elektrike që pëson probleme dhe rrjeti shpërndarës është i amortizuar.

  Sulejman Allko kryeplak fshati shtron kryesore problemin e rrugëve të brendshme, si edhe rrjeti elektrik ka probleme.

  Nëkryetari i bashkisë **Aurel Karriqi** sqaron se do vendosim në dispozicion vetëm për Njësinë Stravaj një fadromë në mënyrë që të sistemohen rrugët.

Mbajtësi i procesverbalit

Koordinatori për Njoftimet dhe konsultimet publike

Rudina Kukli




BASHKIA PRRENJAS
BASHKIA PRRENJAS
BUXHETIM ME
PJESËMARRJE



